



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

---

---

**NR. 146 AKTI**

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me trup gjykues te perbere nga:

**GJYQTARI                      KRESHNIK OMARI**

i asistuar nga sekretarja Teuta Kasneci dhe me pjesemarrjen e prokurorit Hysni Mulaj, sot ne Tirane, me 15.01.2010, mori ne shqyrtim çeshtjen penale qe i perket:

**KERKUES**

A.B, i biri i (.....), i dtl....., lindur ne (.....) dhe banues ne(.....), Tirane, i perfaqesuar nga Av.Artan Kukeli, me prokure te posaçme.

**OBJEKTI**

Kthimin dhe lenien ne ruajtje te autovetures se markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....), bashke me çelesin e saj, si dhe Lejen e qarkullimit nr.TR (.....) date 21.11.2007 te mjetit te mesiperm dhe prokuren e posaçme nr.6888 REP dhe nr.1822 KOL date 05.11.2008 te perpiluar nga notere Manushaqe Sharka, Tirane dhe te sekuestruara me “Vendimin per sekuestrimin e proves materiale” te dates 09.11.2009, nga ana e oficerit te policise gjyqesore Florenc Gjata.

**BAZA LIGJORE** : Nenet 128, 301 dhe 214 te K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi e shqyrtoi çeshtjen ne teresi dhe ne perfundim degjoi avokatin qe kerkoi pranimin e kerkeses, si dhe prokurorin qe kerkoi rrezimin e saj

## V E R E N

Me “Procesverbalin per sekuestrimin e proves materiale” te dates 09.11.2009, nga ana e OPGj Florenc Gjata, pronarit A.B i eshte sekuestruar autovetura e markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....), bashke me çelesin e saj, si dhe Leja e qarkullimit nr.TR (.....) date 21.11.2007 e mjetit te mesiperm dhe prokura e posaçme nr.6888 REP dhe nr.1822 KOL date 05.11.2008, e perpiluar nga notere Manushaqe Sharka. Sipas procesverbalit, bllokimi eshte bere per faktin se Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka rregjistruar procedimin penal nr.1299 date 03.04.2009 per vepren penale te trafikimit te mjeteve motorrike.

Nga ana e prokurorit u kerkua rrezimi i kerkeses se A.B, pasi mjeti i siperpermendur rezultonte ise ishte denoncuar si i vjedhur ne Itali ne daten 25.11.2007.

Ne kete gjykate ka paraqitur kerkese shtetasi A.B, i cili kerkon qe mjeti i sekuestruar nga Organi i Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane, dhe konkretisht, autovetura e markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....), pasqyruar ne “Procesverbalin per sekuestrimin e proves materiale” te dates 09.11.2009, te perpiluar nga OPGj Florenc Gjata, ti kthehet dhe lihet ne ruajtje atij si pronar aktual, me detyrimin per ta paraqitur prane organit procedues, sa here te kerkohet prej ketij te fundit, duke qene se po zhvillohen hetime per kete autoveture.

Nga shqyrtimi gjyqesor i kesaj kerkese, rezulton se ajo eshte e drejte, e mbeshtetur ne provat qe u administruan dhe si e tille ajo duhet te pranohet, duke konsideruar sa vijon:

Keshtu, u provua se OPGj Florenc Gjata, me “Procesverbalin per sekuestrimin e proves materiale” te dates 09.11.2009, ka vendosur sekuestrimin e automjetit me te dhenat si me siper, automjet i cili ne kohen e sekuestrimit ka qene ne pronesi te kerkuesit A.B.

Kerkuesi A.B, duke u legjitimuar ne kerkimet e tij, pasi siç rezulton nga aktet, ai rezulton te jete pronar i mjetit, nepermjet avokatit te tij, parashtrroi perpara gjykates se nuk kishte dijeni qe mjeti i markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....) mund te kishte probleme e aq me pak se mund te ishte i vjedhur ndryshe ai nuk do ja kishte blere pronarit te meparshem te saj, shtetasit Xh.K. Mjeti, pasi eshte kontrolluar dhe ka rezultuar i rregullt ne lidhje me pronsine dhe detyrimet doganore, eshte pajisur edhe me certifikate pronesie, (.....) date 19.02.2008 nga ana e D.R.SH.T.R Tirane.

Pervec kesaj, gjykata u be me dije, se ndonese nga ana e Oficerit te Policise Gjyqesore, prane Drejtorise se Policise se Qarkut Tirane, eshte mbajtur proces verbali i sekuestrimit si me siper, ai proces verbal rezulton i pa vleresuar nga prokurori si i ligjshem, kriter ky i domosdoshem i parashikuar nga ligjvenesin ne nenin 301/2 te Kodit te Procedures Penale, ne te cilin ne menyre te shprehur percaktohet se “ ...Prokurori, brenda 48 oreve te ardheshme, me vendim te motivuar vlereson sekuestron, neqoftese ekzistojne kushtet, ose vendos kthimin e sendeve te sekuestruara...”. Pikerisht, nga aktet e administruara, nuk

ekziston asnje vendim mbi vleresimin e sekuestrimit si me siper, duke e bere ne kete menyre te pavlefshem, veprimin procedural te sekuestrimit te mjetit dhe dokumentacionit te tij.

Pikerisht, duke u mbeshtetur ne sa siper, ne faktin se prokuroria po zhvillon nje hetim lidhur me autoveturen ne fjale, si edhe ne faktin se, siç konstatohet, kerkuesi A.B ndodhet ne pozitat e mirebesimit, gjykata vlereson se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet te pranohet, duke ju kthyer dhe lene ne ruajtje shtetasit A.B, autovetura e markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....), bashke me dokumentacionin e sekuestruar, sipas "Procesverbalit per sekuestrimin e proves materiale" te dates 09.11.2009, nga ana e OPGj Florenc Gjata.

Kerkuesi A.B ka detyrimin ta ruaje, te mos e shese dhe ta paraqese mjetin kurdo qe i kerkohet nga organi procedures, deri ne perfundim te hetimeve ose te gjykimit.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, ne baze te nenit 128, 301 dhe 214 te K.Pr.Penale

### **V E N D O S I**

Kthimin dhe lenien ne ruajtje kerkuesit A.B, te autovetures se markes Mercedes Benz, me ngjyre te zeze, me targe (.....) dhe Nr. Shasie (.....), bashke me çelesin e saj, si dhe Lejen e qarkullimit nr.(.....) date 21.11.2007 te mjetit te mesiperme dhe prokuren e posaçme nr.6888 REP dhe nr.1822 KOL date 05.11.2008 te perpiluar nga notere Manushaqe Sharka, Tirane dhe te sekuestruara me "Vendimin per sekuestrimin e proves materiale" te dates 09.11.2009, nga ana e oficerit te policise gjyqesore Florenc Gjata.

Kerkuesi A.B, ne baze te nenit 214/2, ka detyrimin te ruaje dhe te paraqese autoveturen kur i kerkohet nga organi procedues.

Shpenzimet procedurale siç jane bere.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane sipas ligjit.

U shpall sot, me 15.01.2010.

**S E K R E T A R E**

**G J Y Q T A R**

**TEUTA KASNECI**

**KRESHNIK OMARI**